



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
14 Nr819/24  
Dt. 01.10.2024

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese DSHP-së dhe ZPP-së , më dt 01.10.2024 merrë:

**V E N D I M**

Emërohet Menaxherë i kontratës përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: Furnizimi dhe montimi i ulseve për nxënës dhe shportave për mbeturina në oborret e shkollave “, me numër të prokurimit: VU644-24-8291-1-3-6 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-24-2-075-136, si vijon :

Enver Rruka emërohet menaxher i kontratës.  
Albanez Tahiraj , emërohet mbikëqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës.

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

**Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :**

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / rnobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohej nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim mes Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës , Menaxheri i Projektit do të lëshoi Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të

kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

**Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë me sa vijon:**


- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësime të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.

**4. Për Komision të Pranimit të mallit të porositur dhe të furnizuar sipas projektit Numri I prokurimit: VU644-24-8291-1-3-6 Numri I brendshëm: VU644-24-075-1-3-6 Titulli: Furnizim dhe montimi I ulëseve për nxënës dhe shportave për mbeturina në oborret e shkollave emëroi:**

1. Zehra Kovaçi – kryesues
2. Ruzhdi Igrishta – anëtar
3. Ardian Jashari – anëtar

4. Komisioni, si në nenin 3 të këtij Vendimi, secili për pjesën e tij të përgjegjësisë, ka për detyrë të bëjë kontrollin cilësorë dhe sasiorë të furnizimeve dhe / ose shërbimeve sipas Kërkesës – Porosisë për blerje të Njësisë Kërkuese të cilën e përfaqëson, si dhe pranimit të mallit të dorëzuar, ku kryes i furnizimeve për materialin sipas përshkrimit **“Furnizim dhe montimi I ulëseve për nxënës dhe shportave për mbeturina në oborret e shkollave”** është OE : **“BEREQETI - ING** të cilën e përfaqëson Arben Mazreku , në bazë të kontratës nr. C/953me datë 25.09.2024.
5. Komisioni do të filloi me punë me të pranuar të këtij Aktvendimi ndërsa do të bashkëpunoi ngushtë, në çdo kohë, me Menaxherin e Kontratës të Njësisë Shpenzuese gjegjëse si dhe Menaxherin e Kontratës të Kontraktuesit.
6. Nëse Komisioni konstaton të meta dhe/ ose parregullësi në cilësinë ose përshtatshmërinë e mallit të dorëzuar, atëherë Komisioni do të caktoj afatin për mënjanimin e parregullsive dhe / ose mangësive të konstatuara dhe të pranoi mallin pas mënjimit të mangësive të konstatuara.
7. Nëse komisioni konstaton se nuk ka të meta, atëherë do të hartoi **Raport në të cili do të konfirmoi** përfundimin e furnizimeve të Porositura , të cilin, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit dhe Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t’ia dërgoi, një kopje Kryesit të furnizimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm.
8. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – **Komunës së Vushtrrisë** dhe Operatori Ekonomik : **“BEREQETI - ING, Parku i biznesit Drenas, 130000, DRENAS, Kosovë**

- Kopje: 1 x 1 Menaxheri i Kontratës;  
1 x 1 Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;  
1 x 1 Komisionit të pranimit të mallit;  
1 x 1 Drejtorisë së Prokurimit.

  
Ferit Idrizi  
Kryetar i Komunës



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644-24-8291-1-3-6/C953  
14 Nr. 790/24  
Dt. 25.09.2024

Palët kontraktuese :

## KONTRATË FURNIZIMI

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. “**Bereqeti Ing**” emri i biznesit, me seli në **Drenas**, me ARBK : **810845638**, të cilën e përfaqëson **z. Arben Mazreku**, në tekstin e mëtejshëm: **FURNIZUESI**, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizimi dhe montimi i ulëseve për nxënës dhe shportave për mbeturina në oborret e shkollave**, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	82	9	1	1	3	6
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	0	7	5	1	3	6

### Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Furnizimi dhe montimi i i ulëseve për nxënës dhe shportave për mbeturina në oborret e shkollave**, si vijon:  
- SHF “**Mustafë Venhari**” – Vushtrri; SHFMU “**28 Nëntori**”; në SHFMU “**Rilindja**”; SHMU - 1; SHFMU në fsh. **Pestovë**; dhe SHMP “**Bahri Haxha**” në Vushtrri.
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: jo më gjatë se 20 ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit të kontratës.
- 1.3 Vendi i dërgimit dhe montimit do të jetë : **ulëset për nxënës të shkollave dhe shportat për mbeturina do të montohen në hapësirat e oborreve të shkollave të saktësuara si në nenin 1.1 të kësaj Kontrate**, në sasi, cilësi dhe përshtatshmëri në pajtim të plotë me Specifikat Teknike dhe Planin e shpërndarjes. Kontraktuesi do të ketë bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Menaxherin e Kontratës të A.K. dhe drejtorin e institucionit gjegjës. Formatit, modeli dhe materiali i përdorur për prodhimin e ulëseve për nxënës dhe shportave për mbeturina duhen të jenë në pajtim me Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit dhe e kësaj Kontrate.
- 1.4 Incotermit i aplikueshëm do të jetë **DDP<sup>1</sup>** (Detyra e Dërguar e Paguar).

### Neni 2 Ligji i aplikueshëm

- 2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3,900.00€ ( tremijënaqind/00 Euro)**.

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

#### Neni 4

##### Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pasi që Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim pranim-dorëzimin dhe montimin e ulëseve për nxënës dhe shportave për mbeturina, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se ulëset për nxënës dhe shportat e mbeturinave janë dorëzuar, montuar dhe pranuar nga personat kompetent në institucionin në fjalë, si në aspektin sasior ashtu dhe në aspektin cilësor e të përshatshmërisë. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe komisioni i Pranimit të Mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimet dhe / ose shërbimet e përfunduara.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### Neni 6

##### Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve dhe / ose shërbimeve është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisa e dorëzuar duhet, në të gjitha aspektet, ti plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranimit të mallit dhe përfundon në një afat prej minimum 12 muajve nga data e pranimit të mallit nga Menaxheri i Kontratës i A.K. Dokumenti – Deklaratë me shkrim që konfirmon garantimin e kualitetit dhe evitimin e defekteve eventuale të shfaqura në inventar brenda periudhës garantuese, e nënshkruar dhe vulosur nga Kontraktuesi.

#### Neni 8

##### Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve dhe / ose shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### Neni 9

##### Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### Neni 10

##### Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## Neni 11

### Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## Neni 12

### Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

## Neni 14

### Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër. E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna  
Vushtrri

Për Kontraktuesin : “ Bereqeti - Ing “– Drenas

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Arben Mazreku
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25.09.2024	Data:	25.09.2024
Vula:		Vula:	

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: VU644-24-8291-1-3-6/C953

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Komerciale në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.
Siguria e ekzekutimit	8.1	: 10 % ( dhjetë përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës. Dokumenti - Polisa e sigurimit apo dokument banka të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 60 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës
Sigurimi	9.1	
Cilësia e furnizimeve	16.2	Pranimi paraprak është i nevojshëm dhe do të kryhet nga ana e Menaxherit të Kontratës - Komisionit të Pranimit të Mallit.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së mallit do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lënd e kësaj kontrate, nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisionit të Pranimit të Mallit, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Menaxherit të Kontratës dhe Komisionit të Pranimit të Mallit – Autoritetit Kontraktues.
Dorëzimi	19.3	Dorëzimi konsiderohet i përfunduar pas pranimit dhe konfirmimit të cilësisë, përshtatshmërisë dhe sasisë së mallit të pranuar nga Komisioni për pranim të mallit.
Obligimet garancionit	22.1	Kontraktues është përgjegjës për cilësinë dhe sasinë e mallit të dorëzuar në momentin e kontrollit të cilësisë dhe sasisë së mallit që është object i kontrollit nga ana e Komisionit për Pranim të Mallit
	22.5	Në rast të vlerësimit negative të cilësisë apo sasisë së mallit nga ana e Komisionit për Pranim të Mallit, Kontraktuesi është i obliguar të verpoj sipas Rekomandimit të Komisionit dhe Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Konform nenit 31 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.


Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normen e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 1 formatin 0%, 8%-apo-18%. Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetë

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH
<b>I</b>	<b>Furnizim me ulëse dhe shporta për oborre të shkollave</b>							
2	Ulëse për oborr të shkollës - nga metali dhe druri me gjatësi 120 cm pa mbështetje që vendosen në tokë, dimensiononi i ulëses 45 cm lartësi, gjërsia - vendi për ulje 60 cm, profili nga metali 25x40 mm, druri I thate me 10 cm gjerësi me 5 cm trashësi .Metali dhe druri duhet te jene te ngjyrosura sipas njesise kerkuese.	COPË	25	88.10	0.80	88.80		2220.00
3	Shporta për mbeturina në formë rrethore prej metali e mbeshtjellur me dru e perforcuar per toke.	copë	28	59.52	0.80	60.00		1680.00
<b>TOTALI I PERGJITHSHEM ME TVSH</b>							<b>0.00</b>	<b>3,900.00</b>


**IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)**

**EMRI I OE:** Bereqeti Ing sh.p.k

**EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:** Arben Mazreku

**NËNSHKRIMI:** 

**DATA:** 19.08.2024

**VULA:** 

Numri i prokurimit: VU644-24-8291-1-3-6 Numri i brendshëm: VU644-24-075-1-3-6 Titulli: Furnizim dhe montimi i ulëseve për nxënës dhe shportave për mbeturina në oborret e shkollave

18, e jo në tore
Totali (me TVSH) €
2220.00
1680.00
3,900.00

## AUTORITETI KONTRAKTUES

---

KOMUNA E VUSHTRISË, SHESHI " HASAN PRISHTINA " NR 173, 42000, VUSHTRRI,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: VU644-24-8291-1-3-6

### OPERATOR EKONOMIK:

---

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: BEREQETI - ING, Parku i biznesit Drenas, 130000, DRENAS, Kosovë

E-mail: bereqeti\_ing@hotmail.com

Personi kontaktues: Arben Mazreku

Telefoni: 049-386-007

Faxi:

Numri fiskal: 810845638

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):